



# Pyetëson i Thjeshtë e Matjes së Varfërisë Shqipëria

Mark Schreiner dhe Jean Paul Sossou

1 tetor 2018

This document and a data-collection tool are in English at [scorocs.com](http://scorocs.com)  
Ky dokument dhe një anketë e mbledhjes së të dhënave gjendet në gjuhën shqipe në [scorocs.com](http://scorocs.com)

## Konspekt

Pyetëson i Thjeshtë e Matjes së Varfërisë për Shqipërinë (*the Scorocs Simple Poverty Scorecard-brand poverty-assessment tool*) është një mënyrë transparente me kosto të ulët për programet ndihmuese për të varfrit për të vërtetuar dhe përmirësuar performancën sociale të tyre duke njohur gjendjen socio-ekonomike të pjesëmarrësve të saj. Përgjigjet ndaj 11 treguesve të rezultateve mund të merren në rreth 10 minuta dhe më pas të përdoren për të vlerësuar shkallën e varfërisë të bazuar në konsum, për të gjurmuar ndryshimet në shkallën e varfërisë ose për të ndarë pjesëmarrësit për trajtim të diferencuar.

## Mirënjohje

Falënderojmë Institutin e Statistikave të Shqipërisë, i cili na siguroi të dhënat.  
Përkthimi në shqip është kryer nga Denis Haska, [denis@albtranslations.com](mailto:denis@albtranslations.com).

**Legal:** "Scorocs" and "Prove and improve the good you do" are Trademarks (and "Simple Poverty Scorecard" is a Registered Trademark) of Scorocs, L.L.C. for its brand of poverty-assessment tools. Copyright © 2018 Scorocs.

## Anketa e Thjeshtë e Matjes së Varfërisë

ID e intervistës: _____	<b>Emri</b>	<b>Identifikuesi</b>
Data e intervistës: _____	Pjesëmarrësi: _____	_____
Shteti: <u>ALB</u>	Agjenti në terren: _____	_____
Pyetëtori: <u>001</u>	Pika e shërbimit: _____	_____
Pesha e kampionit: _____	Numri i anëtarëve të familjes: _____	

Treguesi	Përgjigjja	Pikë
1. Në cilën prefekturë jeton familja?	A. Fier ose Gjirokastrë B. Tiranë ose Vlorë C. Durrës ose Kukës D. Elbasan E. Berat ose Lezhë F. Korçë, Shkodër, ose Dibër	0 1 2 3 5 6
2. Sa anëtarë ka familja?	A. Gjashtë ose më shumë B. Pesë C. Katër D. Tre E. Një ose dy	0 9 18 26 45
3. A vuan ndonjë prej anëtarëve të familjes nga një paaftësi që ka zgjatur më shumë se tre muaj?	A. Po B. Jo	0 2
4. Gjatë 7 ditëve të fundit, a ka punuar kryefamiljari/bashkëshorti (të paktën një orë) për dikë jashtë familjes, për shembull, për një ndërmarrje ose kompani publike apo private, një OJQ apo ndonjë individ tjetër? Apo ka punuar në një fermë në pronësi të tij ose të marrë me qira nga ai apo një anëtar i familjes, qoftë në kultivimin e të mbjellave, në detyra të tjera të mirëmbajtjes së fermës ose të kujdeset për bagëtitë që i përkasin atij ose një anëtar i familjes? Apo ka punuar për llogari të tij ose në një ndërmarrje biznesi në pronësi të tij ose një anëtar i familjes, për shembull, si tregtar, shitës, berber, rrobaqepës, zdrukthëtar, shofer taksie, larje makinash, e kështu me radhë? Apo ka pasur një punë të përhershme/afatgjatë nga e cila bënte mungesa përkohësisht?	A. Jo  B. Nuk ka maskull kryefamiljar/bashkëshort  C. Po	0  2  6
5. Cili është statusi i qiramarrjes së banesës ku banon familja e tij?	A. Në pronësi (tapia në proces), me qira, pa qira ose tjetër B. Në pronësi me tapi	0 4
6. Sa dhoma zë familja, duke përfshirë verandat, ballkonet, banjat, tualetet, korridoret, depot ose dhomat më të vogla se 4 m <sup>2</sup> ?	A. Një ose dy B. Tre C. Katër ose më shumë	0 4 6
7. A ka banesa një kuzhinë më vete?	A. Jo B. Po	0 3
8. A ka familja të paktën një WC brenda banesës? (mos llogarisni WC-të që janë brenda ndërtesës, por jo brenda banesës)	A. Jo B. Po	0 4
9. A zotëron familja një aparat për të parë video/DVD, një marrës satelitor/kabllor ose një dekoder televiziv në gjendje pune të mirë?	A. Jo B. Aparat për të parë video/DVD ose marrës satelitor/kabllor, por jo dekoder televiziv C. Dekoder televiziv (pavarësisht nga të gjitha të tjerat)	0 3 8
10. A ka familja në pronësi një bolier uji në gjendje pune të mirë?	A. Jo B. Po	0 4
11. Sa telefona celularë në gjendje pune të mirë zotëron familja?	A. Asnjë B. Një C. Dy D. Tre ose më shumë	0 5 9 12

## Fleta e pasme e punës: Anëtarët e familjes

Plotësoni në fillim kokën e rezultateve. Përfshini numrin unik të identifikimit të intervistës (nëse dihet), datën e intervistës, dhe vlerat e kampionimit të pjesëmarrësit (nëse dihet). Pastaj shënoni emrin e plotë dhe numrin unik të identifikimit të pjesëmarrësit (i cili mund të ndryshojë nga i anketuari), agjenti në terren i pjesëmarrësit (i cili mund të ndryshojë nga ju, anketuesi) dhe pikën e shërbimit që përdor pjesëmarrësi (nëse dihet). Rrethoni përgjigjen për treguesin e parë të rezultateve në bazë të prefekturës ku jeton familja.

Më pas lexojini të anketuarit: *Ju lutem më thoni emrat (ose nofkat) e të gjithë anëtarëve të familjes suaj, duke filluar me kryefamiljarin dhe vazhduar me bashkëshortin/en (nëse ka bashkëshort/e). Një familjare është një njësi ekonomike e një ose më shumë njerëzve—pa marrë parasysh lidhjen e gjakut ose marrëdhëniet sociale—të cilët jetojnë së bashku në të njëjtën banesë, ndajnë një buxhet të përbashkët, dhe hanë së bashku të paktën një herë në ditë. Anëtarët e familjes duhet të kenë përmbushur këto kritere për të paktën 11 muaj ose t'i përmbushin tani dhe të synojnë të vazhdojnë për një kohëzgjatje të totale prej të paktën 11 muaj.*

Shkruani emrin/nofkën e çdo anëtari të familjes. Shënoni kush është mashkulli kryefamiljar/bashkëshorti (nëse ekziston) dhe kush është femra kryefamiljare/bashkëshortja (nëse ekziston). Regjistroni numrin e anëtarëve të familjes në kokën e rezultateve pranë “Numri i anëtarëve të familjes?”. Pastaj rrethoni përgjigjen për treguesin e dytë të rezultateve në lidhje me numrin e anëtarëve të familjes.

Lexoni nëntë pyetjet e mbetura me zë të lartë, duke shënuar përgjigjet.

Gjithmonë kini parasysh dhe zbatoni udhëzimet e hollësishme në “Udhëzuesin e Intervistës”.

<b>Emri ose nofka</b>	<b>Kryefamiljari ose bashkëshorti i kryefamiljarit?</b>
1.	Kryefamiljar (mashkull) Kryefamiljar (femër)
2.	Bashkëshorti (mashkull) Bashkëshortja (femër) Tjetër
3.	Tjetër
4.	Tjetër
5.	Tjetër
6.	Tjetër
7.	Tjetër
8.	Tjetër
9.	Tjetër
10.	Tjetër
11.	Tjetër
12.	Tjetër
<b>Numri i anëtarëve të familjes:</b>	—

# Udhëzues për intervista

Fragmentet e cituara këtu janë marrë nga:

Institute of Statistics. (2012) “Interview Manual: Living Standards Measurement Survey 2012” [*Manuali*].

## Udhëzimet bazë të intervistës

Pyetësi mund të plotësohet në letër dhe përgjigjet e mëvonshme të plotësohen në një fletëllogaritëse, sistemin tuaj të mbledhjes së të dhënave ose sistemin e mbledhjes së të dhënave në linjë të Scorocs. Ky sistem funksionon në një shfletues interneti ose në një aplikacion Android, kështu që lejon futjen e të dhënave jo vetëm nga zyra, por edhe nga terreni. Nëse nuk ka lidhje, atëherë të dhënat ruhen deri sa të mund të ngarkohen në linjë. Testoni sistemin e Scorocs [këtu](#), ose [kërkoni një llogari private](#).

Pyetësi duhet të plotësohet personalisht në banesën e pjesëmarrësit nga një anketues i trajnuar për ta ndjekur këtë “Udhëzues”.

Plotësoni fillimisht kokën e pyetësit dhe “Fletën e pasme të punës”, duke ndjekur udhëzimet në “Fletën e pasme të punës”.

Në kokën e pyetësit, plotësoni numrin e anëtarëve të familjes në bazë të listës që keni bërë si pjesë e “Fletës së pasme të punës”.

Mos bëni drejtpërdrejt pyetjen e treguesit të parë të rezultateve (“Në cilën prefekturë jeton familja?”). Në vend të kësaj, plotësoni përgjigjen përkatëse në bazë të njohurive tuaja mbi prefekturën ku jeton familja.

Në të njëjtën mënyrë, mos bëni drejtpërdrejt pyetjen e treguesit të dytë të rezultateve (“Sa anëtarë të familjes ndodhen aty?”). Në vend të kësaj, plotësoni përgjigjen e duhur në bazë të numrit të anëtarëve të familjes që keni shënuar në “Fletën e pasme të punës”.

Bëjini të anketuarit të gjitha pyetjet e mbetura të pyetësit.

## Këshilla intervistimi të përgjithshme

Studioni me kujdes këtë “Udhëzues”, dhe mbajeni me vete ndërsa punoni. Ndiqni udhëzimet në këtë “Udhëzues” (duke përfshirë edhe këtë).

Mos harroni që i anketuari i intervistës nuk duhet të jetë detyrimisht i njëjti person me anëtarin e familjes i cili është pjesëmarrës në organizatën tuaj.

Në mënyrë të ngjashme “agjenti në terren” që regjistrohet në kokën e pyetësit nuk është domosdoshmërisht i njëjti me ju, anketuesin që po bën intervistën. Përkundrazi, “agjenti në terren” është punonjësi i programit ndihmues për të varfrit me të cilin pjesëmarrësi ka një marrëdhënie të vazhdueshme. Nëse programi nuk ka një agjent terreni të tillë, atëherë lërin bosh përgjigjet në kokën e pyetësit.

Lexoni çdo pyetje fjalë për fjalë, në renditjen e paraqitur në pyetësit. Mos lexoni me zë të lartë opsionet e përgjigjes.

Kur shënoni një përgjigje të një treguesi të rezultateve, rrethoni opsionin e përgjigjes, dhe vlerën e pikëve të saj dhe shkruajeni vlerën në kolonën “Pikë”, kështu:

6. Sa dhoma zë familja, duke përfshirë verandat, ballkonet, banjat, tualetet, korridoret, depot ose dhomat më të vogla se 4 m <sup>2</sup> ?	A. Një ose dy	0	
	B. Tre	4	4
	C. Katër ose më shumë	6	

Për të ndihmuar në pakësimin e gabimeve, duhet:

- Të rrethoni opsionin e përgjigjes të printuar paraprakisht
- Të rrethoni pikët e pyetësit të printuar paraprakisht dhe
- Të rrethoni pikët e shkruara me dorë që përkojnë me përgjigjen

Kur shfaqet një problem që nuk është trajtuar këtu, zgjidhja e saj duhet sipas gjykimit të paanshëm të anketuesit, pasi me sa duket, kjo qe praktika e INSTAT në AMNJ 2012. Pra, një organizatë që përdor pyetësit nuk duhet të shpallë ndonjë përcaktim ose rregullore (përveç atyre në këtë “Udhëzues”) që të përdoret nga të gjithë anketuesit e saj. Çdo gjë që nuk trajtohet shprehimisht në këtë “Udhëzues” duhet të lihet në gjykimin e pandikuar të çdo anketuesi individual.

Mos i lexoni të anketuarit opsionet e përgjigjes. Thjesht lexoni pyetjen dhe pastaj ndaloni; prisni përgjigjen. Nëse i anketuari kërkon sqarime ose heziton apo duket i hutuar, atëherë lexoni përsëri pyetjen ose ofroni ndihmë shtesë në bazë të këtij “Udhëzuesi” ose e konsideroni të përshtatshme ju, si anketuesi.

Në përgjithësi, duhet të pranoni përgjigjet e dhëna nga i anketuari. Megjithatë, nëse i anketuari thotë diçka—ose nëse ju shihni ose ndjeni diçka—që sugjeron që përgjigja mund të mos jetë e saktë, se i anketuari është i pasigurt apo se i anketuari dëshiron ndihmë në gjetjen e mënyrës se si të përgjigjet, atëherë duhet ta lexoni përsëri pyetjen dhe të ofroni çfarëdo ndihme që ju e konsideroni si të përshtatshme në bazë të këtij “Udhëzuesi”.

Ndërsa shumica e treguesve në pyetësorit janë të verifikueshme—në përgjithësi—ju nuk duhet të verifikoni përgjigjet. Ju duhet të verifikoni një përgjigje vetëm nëse ka diçka që ju sugjeron se përgjigja mund të jetë e pasaktë dhe kështu që verifikimi mund të përmirësojë saktësinë e të dhënave. Për shembull, mund të zgjidhni të verifikoni nëse i intervistuari heziton, duket nervoz ose jep sinjale se ai/ajo mund të jetë duke gënjyer, e hutuar ose e pasigurt. Po kështu, ndoshta nevojitet verifikim nëse një fëmijë në familje ose një fqinj thotë diçka që nuk përputhet me përgjigjen e një të anketuari. Verifikimi është gjithashtu ide e mirë nëse mund të shihni diçka vetë—siç është një artikull me afat të gjatë përdorimi që i anketuari deklaroi se nuk zotëron ose një fëmijë që ha në dhomë i cili nuk është numëruar si anëtar i familjes—që sugjeron se një përgjigje mund të jenë të pasakta.

Në përgjithësi, zbatimi i pyetësori duhet të imitojë sa më shumë që të jetë e mundur zbatimin e AMNJ 2012 nga INSTAT. Për shembull, intervistat duhet të bëhen personalisht nga një anketues i trajnuar në vendbanimin e pjesëmarrësit, sepse kjo është çfarë bëri INSTAT gjatë AMNJ 2012.

### **Përktimi:**

Në kohën e këtij shkrimi, vetë pyetësi, “Fleta e pasme e punës”, dhe ky “Udhëzues” janë në dispozicion vetëm në gjuhët anglisht dhe shqip. Nuk ka ende përktim zyrtar, profesional në gjuhë të tjera të folura në Shqipëri. Përdoruesit duhet të vizitojnë [scorocs.com](http://scorocs.com) për të parë se cilat përktime janë bërë që nga koha e këtij shkrimi.

Nëse nuk ka një përktim profesional në një gjuhë vendore të caktuar, atëherë përdoruesit duhet të kontaktojnë autorin e këtij dokumenti për ndihmë në krijimin e një përktimi të tillë.

## **Kush duhet të jetë i anketuari?**

Kini parasysh se i anketuari nuk ka nevojë të jetë i njëjti person me anëtarin e familjes që është pjesëmarrës në organizatën tuaj (megjithëse i anketuari mund të jetë po ai person).

Sipas faqes 11 të *Manualit*, i anketuari i preferuar është kryefamiljari.

Nëse një familje përbëhet nga dy ose më shumë çifte të martuar (me ose pa fëmijë), atëherë i anketuari i preferuar është më i moshuari i bashkëshortëve që punon. Nëse asnjë bashkëshort nuk punon, atëherë i anketuari i preferuar është bashkëshorti më i moshuar.

Nëse një familje ka një prind beqar—qoftë një nënë ose një baba pa bashkëshort ose bashkëshorti i të cilit nuk është anëtar i familjes—atëherë ai prind është i anketuari i preferuar. Nëse një familje ka dy ose më shumë prindër beqarë, atëherë i anketuari i preferuar është prindi beqar më i moshuar.

Sipas faqes 39 të *Manualit*, pyetjet duhet t'i drejtohen anëtarit të familjes me më shumë njohuri.

## **Kush është kryefamiljari?**

Vini re se kryefamiljari mund ose mund të mos jetë i njëjti person që merr pjesë në organizatën tuaj (edhe pse kryefamiljari mund të jetë ai person).

Sipas faqes 11 të *Manualit*, mund të përcaktoni identitetin e kryefamiljarit të familjes së intervistuar duke pyetur familjen, “Kush është personi me njohuri më të mirë të aspekteve ekonomike dhe sociale të familjes?” Në përgjithësi, ky është anëtari mashkull më i moshuar që punon. Nëse familja ka të rritur të martuar (me ose pa fëmijë), kryefamiljari në përgjithësi është bashkëshorti mashkull.

## Udhëzime për secilin tregues në pyetësor

1. Në cilën prefekturë jeton familja?
  - A. Fier ose Gjirokastrë
  - B. Tiranë ose Vlorë
  - C. Durrës ose Kukës
  - D. Elbasan
  - E. Berat ose Lezhë
  - F. Korçë, Shkodër ose Dibër

Nëse nuk keni nevojë të pyesni, mos e bëni pyetjen për këtë tregues direkt nga i anketuari. Në vend të kësaj, shënoni përgjigjen e duhur në bazë të njohurisë suaj mbi prefekturën në të cilën jeton familja e intervistuar.



2. Sa anëtarë ka familja?
- A. Gjashtë ose më shumë
  - B. Pesë
  - C. Katër
  - D. Tre
  - E. Një ose dy

Sipas faqeve 10–11 të *Manualit*, një *familje* është “një njësi ekonomike e një ose më shumë njerëzve—pavarësisht nga gjaku ose marrëdhëniet sociale—të cilët jetojnë bashkë në të njëjtën banesë, ndajnë një buxhet të përbashkët dhe hanë së bashku të paktën një herë në ditë.

“Kriteret kryesore për anëtarësim në familje janë nëse një person ha të paktën një vakt në ditë me anëtarët e tjerë të familjes.

“Një familje mund të jetë:

- Një person që jeton vetëm i cili mbështet vetveten dhe mbulon shpenzimet e tij/saj me të ardhurat e tij/saj
- Dy ose më shumë persona që jetojnë bashkë në të njëjtën banesë dhe që ndajnë një buxhet të përbashkët
- Dy ose më shumë persona që nuk kanë lidhje gjaku apo martesë (si studentët) që ndajnë një vendbanim, një buxhet të përbashkët dhe që hanë bashkë një vakt në ditë”

Sipas faqes 13 të *Manualit* personi kualifikohet si anëtar i familjes vetëm nëse ai/ajo ka jetuar bashkë me familjen për të paktën 11 muaj. Përjashtime nga ky rregull përbëjnë personat që aktualisht jetojnë me familjen prej më pak se 11 muaj, por që synojnë të qëndrojnë përgjithmonë me familjen:

- Foshnjat më të vogla se 11 muajshe të lindura nga anëtarët e familjes
- Bashkëshortët e sapomartuar që u bashkuan me familjen ose formuan vetë një familje të re

3. A vuan ndonjë prej anëtarëve të familjes nga një paaftësi që ka zgjatur më shumë se tre muaj?
- A. Po
  - B. Jo

*Manuali* nuk ka informacion shtesë për këtë tregues.

4. Gjatë 7 ditëve të fundit, a ka punuar kryefamiljari/bashkëshorti (të paktën një orë) për dikë jashtë familjes, për shembull, për një ndërmarrje ose kompani publike apo private, një OJQ apo ndonjë individ tjetër? Apo ka punuar në një fermë në pronësi të tij ose të marrë me qira nga ai apo një anëtar i familjes, qoftë në kultivimin e të mbjellave, në detyra të tjera të mirëmbajtjes së fermës ose të kujdeset për bagëtitë që i përkasin atij ose një anëtar i familjes? Apo ka punuar për llogari të tij ose në një ndërmarrje biznesi në pronësi të tij ose një anëtar i familjes, për shembull, si tregtar, shitës, berber, rrobaqepës, zdrukthëtar, shofer taksie, larje makinash, e kështu me radhë? Apo ka pasur një punë të përhershme/afatgjatë nga e cila bënte mungesa përkohësisht?
- A. Jo
  - B. Nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort
  - C. Po

Sipas faqes 18-19 të *Manualit*, nën-pyetja e parë e këtij treguesi (“Gjatë 7 ditëve të fundit, a ka punuar kryefamiljari/bashkëshorti (të paktën një orë) për dikë jashtë familjes, për shembull, për një ndërmarrje ose kompani publike apo private, një OJQ apo ndonjë individ tjetër?”) ka të bëjë me punën për një pagesë ose rrogë.

Nën-pyetja e dytë e këtij treguesi (“Apo ka punuar në një fermë në pronësi të tij ose të marrë me qira nga ai apo një anëtar i familjes, qoftë në kultivimin e të mbjellave, në detyra të tjera të mirëmbajtjes së fermës ose të kujdeset për bagëtitë që i përkasin atij ose një anëtar i familjes?”), ka të bëjë me bujqësinë ose blegtorinë/kullotjen e bagëtive e bërë nga familja, d.m.th. vetëpunësimi në bujqësi.

Nën-pyetja e tretë e këtij treguesi (“Apo ka punuar për llogari të tij ose në një ndërmarrje biznesi në pronësi të tij ose një anëtar i familjes, për shembull, si tregtar, shitës, berber, rrobaqepës, zdrukthëtar, shofer taksie, larje makinash, e kështu me radhë?”) ka të bëjë me vetëpunësimin jo-bujqësor ose me punën e papaguar në një biznes jo-bujqësor të drejtuar nga familja.

Nën-pyetja e katërt e këtij treguesi (“Apo ka pasur një punë të përhershme/afatgjatë nga e cila bënte mungesa përkohësisht?”) ka të bëjë me nëse mashkulli kryefamiljar/bashkëshorti ka punë me rrogë/pagesë, vetëpunësim në bujqësi ose vetëpunësim në jo-bujqësi të cilën zakonisht bën mungesa, por, për ndonjë arsye, nuk ka bërë mungesa gjatë shtatë ditëve të fundit.

Mos e bëni pyetjen e këtij treguesi ashtu siç duket në pyetësor, domethënë, mos i bëni të gjitha pyetjet njëherazi. Në vend të kësaj, ndiqni si më poshtë:

- Nëse nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshorti (të cilën e dini nga përbërja e familjes në “Fletën e pasme të punës”), atëherë mos bëni asnjë nga nën-pyetjet. Në vend të kësaj, shënoni “B. Nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort” dhe vazhdoni tek treguesi i ardhshëm i statusit të qiramarrjes së banesës ku banon familja e tij
- Nëse ka një mashkull kryefamiljar/bashkëshort, atëherë:
  - Bëni nën-pyetjen e parë dhe pritni përgjigjen. Nëse përgjigja është pohuese, atëherë shënoni “C. Po” dhe kaloni tek treguesi i ardhshëm pa pyetur tre nën-pyetjet e tjera
  - Bëni nën-pyetjen e dytë dhe pritni përgjigjen. Nëse përgjigja është pohuese, atëherë shënoni “C. Po” dhe kaloni tek treguesi i ardhshëm pa pyetur dy nën-pyetjet e tjera
  - Bëni nën-pyetjen e tretë dhe pritni përgjigje. Nëse përgjigja është pohuese, atëherë shënoni “C. Po” dhe kaloni tek treguesi tjetër pa bërë nën-pyetjen e fundit
  - Bëni nën-pyetjen e katërt (të fundit) dhe pritni përgjigje:
    - Nëse përgjigja është pohuese, atëherë shënoni “C. Po”
    - Nëse përgjigja është mohuese, shënoni “A. Jo”

Për ta përmbledhur, shënoni “Nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort” në qoftë se nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort. Përndryshe, bëjini nën-pyetjet një nga një, duke pritur përgjigje pas secilës. Sapo merrni një përgjigje pohuese, shënoni “C. Po” dhe kaloni tek treguesi tjetër, duke tejkaluar çdo nën-pyetje të mbetur. Nëse të katërta përgjigjet janë negative, atëherë shënoni “A. Jo”.

Mos harroni se tashmë e dini emrin e mashkullit kryefamiljar/bashkëshortit (dhe nëse ai ekziston) nga përpilimi i “Fletës së pasme të punës”. Kështu, në qoftë se ka një mashkull kryefamiljar/bashkëshort, mos bëni pyetje mekanike (si shembull nën-pyetja e parë), “Gjatë 7 ditëve të fundit, a ka punuar kryefamiljari/bashkëshorti (të paktën një orë) për dikë jashtë familjes, për shembull, për një ndërmarrje ose kompani publike apo private, një OJQ apo ndonjë individ tjetër?”. Në vend të kësaj, përdorni emrin ose nofkën aktuale të mashkullit kryefamiljar, për shembull: “Gjatë 7 ditëve të fundit, a ka punuar Agroni (të paktën një orë) për dikë jashtë familjes, për shembull, për një ndërmarrje ose kompani publike apo private, një OJQ apo ndonjë individ tjetër?” Nëse nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort, atëherë mos i bëni të anketuarit asnjë nga nën-pyetjet, por shënoni “B. Nuk ka mashkull kryefamiljar/bashkëshort” dhe kaloni tek treguesi i ardhshëm i statusit të qiramarrjes së banesës ku banon familja e tij.

Për qëllimet e pyetësorit, mashkulli kryefamiljar/bashkëshorti përcaktohet si:

- Kryefamiljari, nëse është mashkull
- Bashkëshorti/partneri bashkëshortor i kryefamiljares, nëse është femër
- Nuk ekziston, nëse kryefamiljarja është femër dhe nëse nuk ka bashkëshort/partner bashkëshortor që është anëtar i familjes së saj

Vini re se kryetari i familjes mund ose mund të mos jetë i njëjti anëtar i familjes që merr pjesë në organizatën tuaj (edhe pse kryefamiljari mund të jetë ai person).

5. Cili është statusi i qiramarrjes së banesës ku banon familja e tij?
- A. Në pronësi (tapia në proces), me qira, pa qira ose tjetër
  - B. Në pronësi me tapi

Sipas faqes 8 të *Manualit*, banesa është “njësi strehimi e synuar për banim personash, e cila ka një hyrje ose derë duke siguruar hyrje/dalje në rrugë, kat, oborr, ose zona publike të tjera”.

6. Sa dhoma zë familja, duke përjashtuar verandat, ballkonet, banjat, tualetet, korridoret, depot ose dhomat më të vogla se 4 m<sup>2</sup>)?
- A. Një ose dy
  - B. Tre
  - C. Katër ose më shumë

Sipas faqes 40 të *Manualit*, një dhomë është “një hapësirë që është pjesë e një banese që merr dritë dhe ajër nga jashtë dhe është aq e madhe sa të nxërë një shtrat, duke lënë ende hapësirë për një person që të hyjë dhe të dalë.

“Dhomat apo anekset që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt në banesën kryesore konsiderohen ende si pjesë e banesës nëse janë të zëna nga familja”.

Sipas faqes 8 të *Manualit*, banesa është “njësi strehimi e synuar për banim personash, e cila ka një hyrje ose derë duke siguruar hyrje/dalje në rrugë, kat, oborr, ose zona publike të tjera”.

7. A ka banesa një kuzhinë më vete?

A. Jo

B. Po

Sipas faqes 40 të *Manualit*, “Një kuzhinë është një dhomë qëllimi i vetëm i së cilës është gatimi”.

Sipas faqes 42 të *Manualit*, duhet të llogarisni si kuzhina “të gjitha dhomat—duke përfshirë dhomat në anekse—qëllimi i vetëm i së cilave është gatimi”.

Sipas faqes 8 të *Manualit*, banesa është “njësi strehimi e synuar për banim personash, e cila ka një hyrje ose derë duke siguruar hyrje/dalje në rrugë, kat, oborr, ose zona publike të tjera”.



8. A ka familja të paktën një WC brenda banesës? (mos llogarisni WC-të që janë brenda ndërtesës, por jo brenda banesës)
- A. Jo
  - B. Po

Sipas faqes 8 të *Manualit*, banesa është “njësi strehimi e synuar për banim personash, e cila ka një hyrje ose derë duke siguruar hyrje/dalje në rrugë, kat, oborr, ose zona publike të tjera”.

Për qëllimet e kësaj pyetjeje, banesa është streha e caktuar ku banon familja e intervistuar dhe ndërtesa është pallati apo një ndërtesë tjetër me shumë banesa. Për shembull, duhet të shënoni “B. Po” për një familje që jeton në një apartament të një pallati dhe ka një WC brenda banesës së saj. Në të kundërt, duhet të shënoni “A. Jo” për një familje që jeton në një apartament, por nuk ka WC brenda apartamentit të saj edhe nëse familja përdor një WC që është gjithsesi brenda pallatit (por jashtë apartamentit të vetë familjes).

9. A zotëron familja një aparat për të parë video/DVD, një marrës satelitor/kabllor ose një dekoder televiziv në gjendje pune të mirë?
- A. Jo
- B. Aparat për të parë video/DVD ose marrës satelitor/ kabllor, por jo dekoder televiziv
- C. Dekoder televiziv (pavarësisht nga të gjitha të tjerat)

Mos e lexoni pyetjen siç është shkruar. Në vend të kësaj, bëni pyetje që kërkojnë përgjigje Jo/Po për secilën prej këtyre tri artikujve:

- A zotëron familja një aparat për të parë video/DVD në gjendje pune të mirë?
- A ka familja një marrës satelitor/kabllor në gjendje pune të mirë?
- A ka familja një dekoder televiziv në gjendje pune të mirë?

Shënoni përgjigjet si më poshtë:

<u>A ka familja një &lt;ITEM&gt;?</u>			Përgjigja për tu shënuar
Video/DVD	Marrës satelitor/kabllor	Dekoder televiziv	
Jo	Jo	Jo	A
Po	Jo	Jo	B
Jo	Po	Jo	B
Po	Po	Jo	B
Jo	Jo	Po	C
Po	Jo	Po	C
Jo	Po	Po	C
Po	Po	Po	C

10. A ka familja në pronësi një bolier uji në gjendje pune të mirë?

A. Jo

B. Po

*Manuali* nuk ka informacion shtesë për këtë tregues.

11. Sa telefona celularë në gjendje pune të mirë zotëron familja?
- A. Asnjë
  - B. Një
  - C. Dy
  - D. Tre ose më shumë

*Manuali* nuk ka informacion shtesë për këtë tregues.